



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1077 Prot.

Tiranë, më 11.03.2022

V E N D I M

Nr. 3, Datë 11.03.2022

**“PËR SHPALLJEN E NJË VENDI VAKANT PËR ANËTAR TË KËSHILLIT TË
LARTË TË PROKURORISË, PËR KANDIDATËT NGA TRUPA E
PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE TË DREJTËSISË DHE SHKOLLA E
MAGJISTRATURËS”**

Në mbështetje të nenit 135, të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 11 dhe 16, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S A:

1. Të shpall një vend vakant për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës.
2. Shpallja e vendit vakant dhe kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët, sipas nenit 134 të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, të publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

GENCI GJONCAJ